



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS DEÇAN

Numri i lëndës: 2023:146634
Datë: 22.12.2023
Numri i dokumentit: 05113706

C.nr.497/2023

Gjykata Themelore në Pejë, Dega në Deçan, Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin Bajram Cacaj, në çështjen juridike kontestimore të paditësit S.R. nga Komuna e Deçanit, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson M.B.avokate në Deçan, kundër të paditurës Komunës së Deçanit, Drejtoria e Arsimit, me seli në Deçan, me objekt kontesti kompensim i shpenzimeve ushqimore, me vlerë të kontestit 976,00 €, jashtë seance më datë 22.12.2023, mori këtë:

A K T V E N D I M

HEDHET POSHTË padia me numër C.nr.497/2023, e datës 04.07.2023 e paditësit S.R. kundër të paditurës Komuna e Deçanit, Drejtoria e Arsimit, lidhur me çështjen e kompensimit të shpenzimeve ushqimore, për shkak se çështja është gjë e gjykuar (res judicata).

A r s y e t i m

Paditësi S.R, nga Komuna e Deçanit, përmes përfaqësues me autorizim ka ushtruar padi në këtë gjykatë, kundër të paditurës Komuna e Deçanit, Drejtoria e Arsimit, për kompensimin e shpenzimeve ushqimore.

Gjykata duke vepruar sipas padisë të palës paditëse, gjatë shqyrtimit paraprak të të njëjtës duke u përkujdesur sipas detyrës zyrtare nga shikimi në shkresat e lëndës konstatoi se çështja në fjalë është gjykuar-res judicata, ngase për këtë çështje dhe ndërmjet këtyre palëve tani më njëherë është vendosur nga ana e kësaj gjykate.

Deri tek konstatimi i tillë gjykata edhe pasi bëri vlerësimin e aktgjykimit të marrë nga kjo gjykatë të datës 10.11.2023, me shenjen C.nr.379/2022, nga i cili konstatohet se i njëjti është marrë në çështjen kontestimore të paditësit S.R. kundër të paditurës Komuna e Deçanit, Drejtoria e Arsimit, aktgjykim i cili objekt të çështjes kishte kompensim për shujta – ushqim ditorë për 488

ditë punë nga data 26.03.2020 e deri me datën 21.11.2022, andaj nga aktgjykimi në fjalë rezulton se çështja e trajtuar me këtë aktgjykim, është identike me objektin e padisë C.nr.497/2023.

Duke marrë parasysh të lartcekurat, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, e konform nenit 166 par.2 lidhur me nenin 391 pika d. të Ligjit për Procedurën Kontestimore.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË
Dega në Deçan
Departamenti i Përgjithshëm
C.nr.497/2023, datë 22.12.2023

Gjyqtari
Bajram Cacaj

KËSHILLË JURDIKE:

Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa, në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, përmes kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit të Kosovës.